



Prishtinë, 29 mars 2017

KOMUNIKATË PËR MEDIA

ZRRE prezanton propozimin e Strukturës Tarifore para Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Si pjesë e diskutimeve publike për Propozimin e Strukturës Tarifore të energjisë elektrike, përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), me kërkesë të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri sot kanë prezantuar Propozimin e Strukturës Tarifore dhe ndikimet që do të ketë kjo strukturë tek konsumatorët e të gjitha kategorive. Gjatë takimit, anëtarët e Komisionit kanë kërkuar nga përfaqësuesit e ZRRE-së, të ju prezantohen disa simulime të faturave të konsumatorëve nga grupe të ndryshme të konsumit, në mënyrë që të informohen më në detaje me ndikimet që mund të kenë këto grupe nga ndryshimet e strukturës tarifore të propozuar.

Takimi i sotëm është pjesë e takimeve dhe prezantimeve që po zhvillon ZRRE për të diskutuar me të gjitha palët e interesuara Propozimin e Strukturës Tarifore. Me këtë qëllim ZRRE ka mbajtur edhe një seancë dëgjimore të hapur me të gjitha palët e interesuara si dhe takime të veçanta me përfaqësues të bizneseve dhe shoqërisë civile. Po ashtu ZRRE ka vazhduar të pranoj komente nga palët e interesuara përmes postës elektronike dhe të gjitha komentet do të jenë pjesë e shqyrtimit përfundimtar që pritet të bëhet në takimin e ardhshëm të Bordit.